



UDHËZUES PËR EDUKIMIN E FËMIJËS

PËRMBAJTJA

05	Edukimi i sukseshëm
06	Paratë e xhepit
07	Ndihma në punët e shtëpisë
08	Ushqimi dhe lëvizja
09	Nevoja për gjumë
10	Televizioni dhe kompjuteri
12	Smartphone
14	Rregullat e sjelljes në internet dhe të përdorimit të tijë
16	Daljet argëtuese në mbrëmje
18	Puberteti dhe seksualiteti
20	Alkooli, tabaku dhe kanabisi
22	Presioni në shoqëri
24	Mobbing-u
27	Ligji për mbrojtjen e të rinjëve
28	Lirimi i shëndoshë i fëmijës
30	Puna sociale në shkollë
32	Podkastet dhe pikat e kontaktit

TË NDERUAR PRINDËR

Në duart tuaja keni Udhëzuesin Për Edukimin e Fëmijëve, udhëzues ky i punuar nga puntorët për mirëqenie sociale të Kantonit të Glarusit. Ky udhëzues është përpiluar me qëllim që të ju ndihmojë prindërve, edukuesëve të fëmijëve në çdo pyetje apo vështërsi që hasin gjatë edukimit të fëmijës nga mosha parashkollore e deri në moshën adoleshente.

Në të mund të gjeni ide dhe këshilla të ndryshme. Mos të jenë këto rregulla strikte por më mirë të themi udhëzime përgjatë rrugës së edukimit të fëmijës. Do të gjeni ndihmë kur bie fjala për përdorimin e smartphone, parave të xhepit, internetit e shumë tema tjera.



EDUKIMI I SUKSESSHËM

«Respekti, besimi dhe sinqeriteti i dyanshëm»

Nuk ekziston asnjë udhëzues që na garanton edukiminin e sukseshëm të fëmijës. Vlerat qëndrore gjatë edukimit janë respekti, sinqeriteti dhe besimi.

Gjërat që na ndihmojnë gjatë kontaktit me fëmijë dhe adoleshentë janë:

- ▶ Sa më shumë lavdërata dhe dhënje të kurajos sa më pak sharje, mundohuni të shihni anën pozitive të fëmijës
- ▶ Urdhëra dhe rregulla të çarta
- ▶ Bëhuni fleksibil në përpilimin e rregullave
- ▶ Konsekuenca logjike në rast të prishjes së rregullave
- ▶ Sa më shumë përkrahje në raste konflikti

Bëhuni kreativ dhe me plot fantazi. Nëse nuk keni ide apo mënyra juaj nuk po tregon sukses atëherë kërkoni këshilla nga familja dhe farefisi, nga shoqëria , në këshillmore apo edhe tek ne.

Në asnjë mënyrë mos e përdorni dhunën ndaj fëmijës! Fëmijët që e përjetojnë dhunën kanë shumë vështësi në ndërtimin e vetbesimit dhe janë të gatshëm të përdorin dhunën në rast konflikti.

PARATË E XHEPIT

«Edhe përdorimi i parave duhet të mësohet»

Përdorimi dhe ndarja e parave është gjë që fëmija duhet ta mësojë. Prandaj është e kuptueshme që të i ipni para xhepi rregullisht. Me rëndësi është që këto para të i ipen fëmijës pa kushte dhe vetë të vendosë se për çka dhe si do të i shpenzojë. Prandaj shmanguni asaj që t'i shfrytëzoni paratë e xhepit si mjet për edukimin e fëmijës apo mjet për ti bërë presion.

Sipas kushteve, paratë e xhepit i i ipen fëmijës çdo javë, njëherë në dy javë apo një herë në muaj.

Rekomandimet tona:

- ▶ Klasa e 1. deri në klasa e 4. :
1.– deri në 4.– CHF në javë
(duke iu përshtatur moshës)
- ▶ Klasa e 5. dhe klasa e 6. :
20.– deri në 25.– CHF në muaj
- ▶ Klasa e 7. dhe klasa e 8. :
25.– deri në 35.– CHF në muaj
- ▶ Klasa e 9. dhe klasa e 10. :
35.– deri në 50.– CHF në muaj

Nga fillimi i klasave të larta është e mundshme që fëmijës bashkë me paratë e xhepit të i ipen edhe paratë për shpenzimet e telefonit mobil dhe për veshmbathje. Bisedoni me fëmijën dhe bëni ujd lidhur me shumën mujore. Përcaktoni ju, se për çka duhet të shpenzohen ato para gjatë tërë muajit.

Paga e zejtarëve (zanatlinjëve):

Të rinjët të cilët ende banojnë në shtëpi dhe fitojnë para në zanat, mundë të kontribuojnë në kasën e buxhetit shtëpiak, por ky kontribut nuk duhet ta tejkalojë $\frac{1}{3}$ e rrogës së tyre.

Edhe një pagë rinore ta quajmë kështu, është e rëndësishme dhe ndihmon mësimin e të riut se si të gjendet me para. Me pagën rinore nënkuptojmë shumën që të riut i ipet për nevojat personale dhe ato jetësore. Në këtë mënyrë të rinjët mësojnë të marrin përgjegjësi dhe të gjenden me para. Në mësimin e përdorimit të parave, «Paga rinore» e zavendëson «Paratë e xhepit».

Përvoja tregon: Mosha 13 vjeçare është mosha ideale që fëmijës të i ipen përgjegjësi në sfera të definuara të jetës.

NDIHMJA NË PUNËT E SHTËPISË

«Forcimi i vetëpërgjegjësisë»

Është shumë e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjët të ndihmojnë në punët shtëpiake, natyrishtë punë që i përshtaten moshës së tyre. Këtë më së miri mundë t'a arrini duke e përpiluar një plan për punët shtëpiake të strukturuar ku janë të përfshirë edhe fëmijët.

Punë të përshtatshme:

- ▶ Përgatitja e tavolinës së ushqimit / larja e enëve
- ▶ Pastrimi i banjës
- ▶ Pastrimi me fshesë elektrike
- ▶ Pastrimi i biçikletës

USHQIMI DHE LËVIZJA

«Shëndeti dhe fitnesi janë themel i arritjeve të sukseshme»

Çdo mëngjes, para se të shkojë në shkollë/parashkollorë, fëmija duhet që të hanë mëngjesin sepse kjo është e rëndësishme për perceptimin e mësimeve në shkollë. Me bark të zbrazët truri nuk është i aftë të punojë.

Që ushqimi i balansuar dhe i shëndetshëm është shumë i rëndësishëm për psiqikën dhe trupin e njeriut, këtë e dinë shumica prej nesh. Adoleshentët e kanë të vështirë të hanë gjëra të shëndetshme ngase për ata gjërat e pashëndetshme janë COOL. Kjo nuk do të thotë që ata mos të hanë gjëra të tilla.

Kështu që nëse fëmija ka dëshirë të hajë ndonjëherë gjëra të pashëndetshme, atëherë, sidomos për adole-shentët, vlejné këto rregulla:

- ▶ Lëviz që të përjetosh dicka: Ngase jeta nuk zhvillohet vetëm para televizorit apo kompjuterit.
- ▶ Motivoni fëmijën ta përdorë sa më shumë bicikletën, me arsye se mbrin më shpejt prej A në B, por mos harroni t'i thoni ta vendosë helmetën!
- ▶ Apo motivone të regjistrohet në ndonjë shoqatë sportive.

NEVOJA PËR GJUMË

«Furnizimi me fuqi dhe energji»

Për koncentrim dhe aftësi regjistruese të trurit sa më të mirë, fëmija duhet të bëjë gjumë të mjaftueshëm. Edhe fëmijët të cilët ende nuk kanë hyrë në shkollë duhet të bien herët në gjumë, ndërmjet orës 19.00 dhe orës 20.00.

Duhet të përmendet që nevoja për gjumë nga fëmija në fëmijë ndryshon. Me rëndësi është që fëmija të zgjohet në mëngjes i qetë dhe i pushuar dhe ashtu të shkojë në shkollë.

Ikni asaj që ta dënori fëmijën duke e dërguar të flejë, kjo gjë e bënë që fëmija ta lidhë gjumin me ndjenja negative.



TELEVIZIONI DHE KOMPJU- TERI

«Përdorimi i mediave me ekran»

Në grupin e mediave me ekran bëjnë pjesë: smartphone, iPad, playstation, kompjuteri, televizori e tjera. Prindërit duhet të informohen mirë lidhur me këto mjete elektronike, si përdoren dhe mundësitë e përdorimit të tyre. Shumë me rëndësi është që të bisedoni me fëmijët lidhur me mediat. Që të keni më shumë kontrollë lidhur me konsumin e mediave të fëmijës, atëherë asesi mos i vendosni televizor apo kompjuter në dhomë. Kufizoni kohën e përdorimit të mediave, caktoni kohën kur dhe sa fëmija mundë të i përdorë ato, natyrisht duke iu përshtatur moshës.

Në vazhdim rregullat e përdorimit të mediave nga fëmijët:

- ▶ Parashikimet: max. ½ ore në ditë
- ▶ Klasa 1-3: ½ ore në ditë
- ▶ Klasa 4-6: 1 orë në ditë
- ▶ Klasët e larta, 1-3: 2 orë në ditë

- ▶ Ekranet duhet të jenë në afërsi të prindërve dhe kompjuteri duhet të çkyqet totalisht e jo të lihet në modusin standby.
- ▶ Bashkë me fëmijën vendosni se çfarë filmi apo çfarë loje duhet/dëshiron të shikojë/luaj. Shikoni mirë lojrat dhe filmat se a i përshtaten moshës së tij. Por mos harroni çdoherë të kontrolloni se çka shikojnë dhe çka luajnë fëmijët.
- ▶ Televizori dhe kompjuteri janë gjëra që duhet të konsumohen gjatë kohës së lirë, në mëngjes dhe gjatë drekës nuk duhet të përdoren. Çdo konsum duhet të bëhet vetëm atëherë kur fëmija i ka përfunduar detyrat e shtëpisë dhe detyrat tjera që i ka në shtëpi. Bisedoni me fëmijën lidhur me këtë dhe vendosni së bashku për kohën e përdorimit të tyre.



SMARTPHONE

«Bën edhe të mbyllen ndonjëherë»

Telefoni mobil është bërë pjesë e pandashme e jetës tonë të përditshme. Për fëmijët para moshës 12 vjeçare nuk preferohet që të kanë telefon mobil. Marrja me vete e telefonit mobil në shkollë nuk është e nevojshme si dhe pjesërishtë nëpër shkolla edhe e ndaluar.

Është e rëndësishme që të rinjtë të mësojnë se si të përdorin smartfonët e tyre. Nëse prindërit e marrin përsipër pagesën e fakturës së telefonit, si shkëmbim kërkon nga fëmija të merr përsipër detyra shtëpiake shtesë. Poashtu duhet që të caktoni kohën kur nuk duhet të përdoret telefoni mobil, sidomos gjatë drekës, para gjumit, gjatë orarit të mësimet. Një gjë tjetër shumë e rëndësishme është që të bisedoni me fëmijët lidhur me faqet e internetit që nuk janë për moshën e tyre (pornografia, lojë të fatit, dhuna).

Edhe nëse i bllokoni këto faqe në telefonin e fëmijës tuaj, ata mund të i shikojnë ato tek shoku apo shoqja. Shikoni dhe kontrolloni bashkë me fëmijën telefonin, fotografitë, filmat, apps-at të cilat janë të regjistruara në telefonin e tij. Lejoni fëmijët që ata të ua spjegojnë funksionin e tyre. Fëmijët ndër moshën 16 vjeçare e kanë të ndaluar me ligj krijimin, shpërndarjen apo edhe vetëm të shikuarit e videove / filmave pornografik. Prandaj nëse fëmija i përdorë apo i shpërndan ato, atëherë bëhet i dënueshëm nga organet përkatëse.



RREGULLAT E SJELLJES NË INTERNET DHE PËRDORIMIT TË TIJË

«Kompetenca ndaj mediave»

Interneti dhe mediat sociale ofrojnë vlera të mëdha argëtimi, por në të njëjtën kohë përmbajnë rreziqe. Por interneti nuk është vend ku nuk ka ligj dhe të drejta. Keni kujdes nga fotografitë, videot, chat-i, dhe cybermobbing-u. Publikimi i gjërave personale në internet është i pamundur që të kontrollohet. Fshirja plotësisht e tyre nga interneti është poashtu e pamundur, ngase menjëherë pas publikimit të tyre ato regjistrohen në faqe të ndryshme. Edhe pas shumë viteve fotot apo datat tjera mund të gjenden në internet.

Gjëra me rëndësi gjatë përdorimit të internetit:

- ▶ Emrin, adresën, numrin e telefonit, E-Mail-adresën nuk duhet të ia tregoni dikujt të

panjohur.

- ▶ Informohuni lidhur me sigurimin e fëmijëve në internet (faqet e ndaluara, programet filtruese në rrjet).
- ▶ Instagram dhe TikTok janë të lejuara pas moshës 13 vjeçare. Të njohurit në internet nuk janë gjithmonë ashtu siq duken të jenë.
- ▶ A është fëmija yt fer në përdorimin e internetit, a sillet me të tjerët ashtu siq ai dëshiron që të tjerët të sjellen me të? Interesohuni lidhur me fotot dhe komentet që fëmija juaj i publikon. Shikoni mos po e mundon diçka fëmijën tuaj, apo po ndodh dicka e pakënaqshme. Bisedoni me fëmijën tuaj.



DALJET ARGËTUESE NË MBRËMJE

«Tema e përhershme e grindjes»

Dëshira e të rinjëve është që ata të përjetojnë gjëra, si për shembull në ndeja me shoqërinë edhe atë deri natën vonë. Daljet gjatë javës për fëmijët të cilët ende shkojnë në shkollë janë përjashtuese. Vetëm në raste të veçanta, festa të shkollës apo festa të shoqatave sportive mundë të bëhet përjashtim. Të rinjtë duhet të mësojnë se si ta trajtojnë kohën e lirë dhe liritë e tyre.

Pikat në vazhdim duhet të sqarohen para se të dalë fëmija juaj:

- ▶ Kush po e organizon këtë ndejë?
Me kënd po shkon?
çka do të bësh aty?
- ▶ Për çdo rast fëmija duhet të jetë i arritshëm, patjetër kërkoni numrat e telefonave të vendit të ndejës dhe të shoqërisë.
- ▶ Kur do të kthehesh? Merruni vesh se si do të kthehet në shtëpi, me kënd dhe në ora sa?

Në vazhdim udhëzime lidhur me kohën e kthyerjes nga daljet:

Mosha	diele-e enjete	premtë dhe e shtunë
Parashkollorët	deri në ora 17.00	vetëm me përcjellje
Klasët e ulëta	deri në ora 18.00	vetëm me përcjellje
Klasët e mesme	deri në ora 19.30	vetëm me përcjellje
Klasët e larta:		
Klasa e parë	1x deri në ora 21.00	deri në ora 21.00
Klasa e dytë	2x deri në ora 21.30	deri në ora 22.00
Klasa e tretë	2x deri në ora 22.00	deri në ora 23.00
Deri në 18vj.	2x deri në ora 22.00	deri në ora 24.00

Daljet patjetër duhen që të janë të lidhura me besueshmëri dhe përpikëri në orar. Edhe stinët e vitit ndikojnë në orarin e daljeve për shembull verës deri në ora 21.30 por dimrit vetëm deri në ora 21.00.

Mos hezitoni të kontaktoni edhe me prindër tjerë. Shumëherë fëmijët na ankohen se të gjithë po rrinë më gjatë se unë. Bisedoni me prindër, bëni marrveshje me ta.

PUBERTETI DHE SEKSUALITETI

«Thjesht të jesh ndryshe»

Gjatë pubertetit, i cili fillon përafërsisht nga mosha 11 vjeçare dhe zgjat deri në moshën 18 vjeçare, aktivizohen qeliza të veqanta nervore në tru. Kështu që ndodhin ndryshime të jashtëzakonshme si fizike edhe shpirtërore: flokët rriten në vende jo të zakonshme, trupi merr formë si dhe ndjenjat bëhen të ndryshueshme. Në mes të «qenurit fëmijë» dhe asaj «jam i rritur» pubertetasi e pyesin veten «A jam normal?» Me fillimin e pjekurisë seksuale, vajzat dhe djemtë fillojnë të ndjejnë më shpesh dhe me intensitet impulse seksuale. Ata fillojnë që të kujdesen më shumë për pamjen e tyre dhe dëshira për përvojën e parë të puthjeve dhe ledhatimeve fillon të rritet.

Për relacionin prind - fëmijë puberteti sjell ndryshime drastike të cilat janë të ndjeshme për të dy palët. Në njërin anë është ndarja e fëmijëve nga prindërit e cila është e lidhur shumëherë me dhimbje, grindje dhe bren-gosje. Në anën tjetër edhe gjatë pubertetit djemët dhe vajzat ende kanë nevojë për prindër të cilët me dashuri dhe mbështetje ua lehtësojnë rrugën për tu bërë të rritur. Krahas shoqërisë, prindërit mbesin edhe gjatë pubertetit partnerë kontaktues të rëndësishëm në përditshmërinë e adoleshentit si për shembull lidhur me temat lidhja, trupi dhe seksualiteti. Ju më së miri e njihni fëmijën tuaj dhe e vëreni shpejt nëse diçka nuk është në rregull apo ka ndonjë pyetje me rëndësi.

Metoda juaj për t'i shpjeguar gjërat fëmijës tuaj, ndonjëherë mund të jetë e panevojshme apo edhe turpëruese. Mos u shqetësoni, ky është një hap drejt pavarësisë së tyre. Prandaj në këtë situatë e vetmja gjë që ju ndihmon fëmijëve është përkrahja, dhënia e ideve për faqe informative në internet apo blerja e fletushkave të ndryshme, në mënyrë që ata të informohen.

Edhe pse biseda me fëmijë lidhur me trupin, lidhjet dhe seksualitetin është shumë e rëndësishme, shumicën e gjërave fëmijët i mësojnë edhe pa fjalë, duke shikuar. Nëna dhe babai janë shembuj për shumë gjëra, sepse ata sjellen në një mënyrë të veçantë. Për shembull është interesant të shohësh se si prindërit nuk mërzhiten fare për bukurinë (të tepruar) e jashtme dhe parandalimin e plakjes, ata e akceptojnë veten ashtu siq janë.



ALKOOLI, TABAKU DHE KANABISI

«Sjellja ndaj substancave narkotike»

Alkooli dhe tabaku janë gjëra që i kemi çdokund rreth nesh, si në reklama, tek të rinjët, të rriturit, në familje. Se si i sheh fëmija juaj këto substanca dhe personat që i konsumojnë ato dhe se çfarë mendimi krijojnë ata rreth kësaj, ndikoni edhe ju si prindër.

- ▶ Jetoni ashtu që të jeni shembull i mirë në konsumimin e këtyre kënaqësive, pra përdorimi me masë.
 - ▶ Kërkoni bisedën me fëmijën tuaj lidhur me këtë, bisedoni haptas dhe me besueshmëri. Informohuni mirë lidhur me substancat që të bëjnë të varur. Mbani një qëndrim të çartë. Tregoni fëmijës për ndikimet negative që kanë këto substanca.
 - ▶ Ligji e ndalon shitjen dhe dhënien e alkoolit dhe tabakut (përfshirë cigaret elektronike dhe shishet elektronike) tek fëmijët ndër moshën 16 vjeçare. Spirituozët, aperitivët, alcopopsat janë të lejuara vetëm pas moshës 18 vjeçare. Mos i bleni fëmijës alkool dhe mos e dërgoni të blejë alkool.
- ▶ Konsumimi i kanabisit është rrezikues i shëndetit ku paraqiten probleme psikike dhe ato fizike. Prindërit duhet të marrin pozicion të çartë lidhur me këtë. Në asnjë mënyrë mos e përkrahni apo toleroni konsumin e këtyre substancave.
 - ▶ Nëse jeni të shqetësuar lidhur me konsumimin e substancave narkotike të fëmijës tuaj, kërkoni ndihmë sa më heret tek organizatat e ndryshme regjionale si për shembull në BTS në spitalin kantonar, puntorët social, puntorët socialë të shkollës e tjera.



PRESIONI NË SHOQËRI

«Dëshira që edhe unë të jam me ata»

Që njerëzit e njëjtë kanë tendencë të madhe të shoqërohen në mes vete këtë e dijmë të gjithë. Njëjtë ndodh edhe tek shoqërimi dhe formimi i grupeve tek fëmijët dhe të rinjtë. Zakonishtë të rinjtë e një shoqërije i kanë mendimet, vizionet, dëshirat dhe hobi të njëjtë.

Së pari prindërit duhet ta kuptojnë se formimi i grupeve në mesin e të rinjëve është një gjë shumë e natyrshme. Përvoja që fëmija e fiton në grup është e rëndësishme për zhvillimin e tij. Për të rinjtë, akceptimi nga ana e shoqërisë është më i rëndësishëm se sa ai nga ana e prindërve. Dëshira e adoleshentëve është që të janë të njëjtë sikur shoqëria e tyre. Këtë e quajmë edhe «Sjellja e kameleonit».

Por, mos e shihni shoqërinë e fëmijës tuaj si konkurrencë. Zakonisht të rinjtë të cilët janë të pasigurtë, kanë tendencë që të shoqërohen me njerëz, të cilët kanë ndikim të pafavorshëm në zhvillimin e tyre. Në grupin e këtyre njerzëve, ata e ndjejnë vetën të veçantë. Me rëndësi është që ju si prindër ti theksoni anët pozitive të fëmijës tuaj dhe të ia forconi vetëbesimin. Nëse adoleshenti është i kënaqur me veten, nuk ndikohet lehtë nga gjërat negative.

MOBBING-U

«Unë kam të drejtë të jam ashtu siq jam»

Mobbing-u është një formë e dhunës shpirtërore apo edhe fizike. Me mobbing nënkuptojmë situatën kur fëmijëve apo të rinjëve përgjatë një kohe të gjatë u bëhet dhunë psikike apo fizike. Kjo lloj dhune nuk bën të tolerohet në asnjë mënyrë!

Fëmija është viktimë e mobbing-ut në situatat në vazhdim:

- ▶ Fëmija nuk dëshiron të shkojë më në shkollë.
- ▶ Suksesi në shkollë bie dukshëm.
- ▶ Është shpesh i sëmurë, i dhemb lukthi.
- ▶ I humb gjërat personale, gjërat e shkollës i ka të dëmtuara.
- ▶ Nuk ka shoqëri, apo vetëm pak shokë.
- ▶ E nënçmon vetveten, flet keq për veten.
- ▶ Ka çrregullim në apetit dhe në gjumë.
- ▶ Ka lëndime trupore apo shenja të kaltërta në trup.

Për prindërit, zbulimi i mobbing-ut është shumë i vështirë. Shumëherë prindërit janë pa zgjedhje, ndërsa në anën tjetër fëmijët vuajnë, e kërkojnë fajin tek vetja dhe në këtë mënyrë mbyllen në vetvete. Ju si prindër patjetër duhet të bisedoni me fëmijën tuaj, bisedoni për gjërat që e mendojnë dhe merrni seriozishtë ato.

- ▶ Mbështeteni fëmijën tuaj. Besoni fjalëve të tyre, reagoni menjëherë dhe kërkonit ndihmë.
- ▶ Mos e akuzoni fëmijën tuaj e as mos e fajsoni atë.
- ▶ Mobbing-u nuk duhet të akceptohet, nëse nuk flisni në një mënyrë ju e akceptoni atë.
- ▶ Kërkonit ndihmë nga mësuesi apo nga puntorët socialë dhe informoni ata për ngjarjet.

- ▶ Shmanguni asaj që të i konfrontoni ju vetë prindërit e fajtorit/fajtores. Secili njeri ka të drejtë të jetë ashtu siq është dhe të akceptohet. Kërkonit nga fëmijët tuaj që të sillen me të tjerët ashtu siq ata dëshirojnë që të tjerët të sillen me ta. Nuk është e thënë që të kemi shoqëri me të gjithë, poashtu nuk është e mundur të na duken të gjithë simpatik, por me rëndësi është që ta respektojmë dhe tolerojmë njëri-tjetrin. Ta luftosh mobbing-un do të thotë që të jesh shembull!

Fëmijët duhet të mësojnë të dijnë të thuan JO në rast se dikush nuk ua respekton kufijtë. Të flasësh për situata që kanë të bëjnë me mobbing-un në shkollë apo edhe gjatë kohës së lirë nuk ka të bëjë asgjë me thashetheme. Të i ndihmosh viktimës do të thotë të jesh i fortë dhe guximtar.



LIGJI PËR MBROJTJEN E TË RINJËVE

«Të shohësh dhe ta kërkosh bisedën»

Sjellja e çuditshme e fëmijës mund të jetë shenjë paralajmëruese që ai/ajo kanë një problem apo janë në rrezik. Bëni me dije vajzës apo djalit tuaj që jeni për të aty gjithëmonë kur ka nevojë. Kërkoni vazhdimisht bisedën me fëmijën tuaj. Prindërit duhet të informohen dhe pre-gatiten mirë lidhur me gjërat që e mundojnë fëmijën tuaj, në rast nevojë mos hezitoni kërkoni ndihmë nga puntorët socialë të shkollës, nga mësuesit etj.

Fëmijët dhe të rinjtë nga mosha 10 vjeçare, sipas Art. 3, Paragrafi 1 i Ligjit Për Të Rinjë, nëse kanë bërë vepër kundërligjore, mundë të tërheqen në përgjegjësi. Në anën tjetër prindërit, sipas Ligjit Për Të Drejta Civile Art. 296, Paragrafi 1 dhe Art. 301, Paragrafi 1 dhe 2, e kanë detyrë që të kujdesen për mirëqenien e fëmijëve të tyre. Për pyetje tjera ekzistojnë në Kantonin e Glarusit këshillmore të ndyshme. Puntorët socialë të shkollës ju informojnë për këtë.



LIRIMI I SHËNDOSHË I FËMIJËS

«Dy gjëra që prindërit duhet dhënë
fëmijës janë rrënjë dhe krahë». J. W. von Goethe

Me fillimin e klasëve të larta, ngadalë vie koha që të fillojmë lirim e fëmijës. Edhe fëmija duke u rritur dëshironë që të ka të drejtë te bashkë-vendosjes. Prindërit duhet që së bashku me fëmijën të i negociojnë rregullat për fëmijën. Rregullat duhet të janë në atë mënyrë, që ju si prindë të mund t'i leni përgjegjësi pak më të mëdha fëmijës. Por natyrishtë pa i anashkaluar strukturat në formë të një kornize që i përcaktojnë prindërit. Sepse për mbështetje dhe siguri fëmija do të ketë nevojë gjithmonë.

Qëllimi është gjetja e mesit ndërmjet kontrollit dhe lëshimeve ndaj fëmijës. Ta liroshe fëmijën do të thotë t'i japësh guxim, që të shkojë rrugës së vet, të marrë përgjegjësi por gjithmonë duke e pasur mbështetjen e prindërve.

Kusht paraprak për aplikimin e çdo rregulle është mardhënja plot besueshmëri ndërmjet prindit dhe fëmijës. Me aktivitete dhe interesa të përbashkëta e forconi lidhjen tuaj edhe më shumë dhe është bazë për një edukim të suksesshëm. Diskutimi i temave të përditshme si dhe negocijimi i rregullave sa herë që të është mundur, duhet të bëhet së bashku duke i konsideruar interesat e të dy palëve. Kjo gjë kërkon kohë dhe gatishmëri për kompromis si nga ana e prindërve ashtu edhe nga ana e fëmijës.

PUNA SOCIALE NË SHKOLLAT E KANTONIT TË GLARUSIT

Puna sociale për shkolla (gjerm. Schulsozialarbeit, shkurtimisht SSA) nga viti 2013 u ofrohet të gjitha shkollave në Kantonin e Glarusit, në shumicën e shkollave SSA janë prezent ndërsa në shkolla më të vogla sipas nevojës.

Qendër e punës së punonjësve socialë për shkolla janë fëmijët dhe adoleshentët të shkollës përkatëse (parashkollorja, shkolla fillore apo klasët e larta I) Edhe mësimdhënësit, prindërit, autoritetet, departamentet, puntorë të cilët kanë të bëjnë në fushën e shkollës, kanë të drejtë për shërbimin e SSA.

Oferta e punonjësve social të shkollës është e pavarur nga mësimdhënësit dhe drejtorja e shkollës. Këshillimi është vullnetar, anonim dhe falas.

Nëse keni ndonjë pyetje apo vetëm jeni kureshtar, personat profesionalë të SSA e presin me kënaqësi thirrjen tuaj. Adresën tonë përgjegjëse për shkollën tuaj e gjeni në këtë broshurë.

Oferta për prindër nga punëtorët social të shkollës:

- ▶ Konsultim i shkurtër: Ndhurma e puntorëve social është atëherë e dobishme kur prindërit kërkojnë këshilla profesionale dhe falas. Poashtu nëse gjendeni në situata të vështira jetsore dyert i kemi të hapura për ju.
- ▶ Ju udhëzojmë dhe informojmë për këshillmore dhe oferta tjera ndihmëse.

Oferta për fëmijë dhe adoleshentë nga punëtorët social të shkollës:

- ▶ Konsultime/këshilla nëse keni probleme personale, sociale apo familjare. Konsultimi mundë të jetë i vetëm, familjar apo në grup: Këto konsultime rezultojnë nga kontakte të rënda/me pengesa por edhe me kërkesën e mësimdhënësve apo prindërve.

Oferta për shkollë, mësimdhënës, udhëheqsinë e shkollës për preventivë nga punëtorët social të shkollës:

- ▶ Njohja dhe intervenimi me kohë në rast rreziku apo problemi.

- ▶ Oferta dhe projekte preventive lidhur me temat aktuale si sjellja në shoqëri, zgjidhja e konflikteve, për pyetjet reth gjinisë apo prejardhjes; Shoqërim gjatë ndërrimit prej klasave të ulta në të larta apo në gjimnaz.
- ▶ Bashkëpunim dhe pjesëmarrje në projektet e zgjedhura interne të shkollës.

Ndërhyrjet profesionale:

- ▶ Në mes nxënësve dhe nxënëseve.
- ▶ Në klasë në rast konflikti dhe situata të krizës me kërkesën dhe në marrëveshje me mësimdhënësit dhe udhëheqësinë e shkollës.
- ▶ Konsultime të shkurtëra me mësimdhënës, udhëheqësinë e shkollës dhe me autoritetet në temat vendime/kërkesa sociale si dhe pyetje të ndryshme lidhur me edukimin e fëmijës.
- ▶ Intervenim tek nxënësit në situatë krize ku nevojitet reagim urgjent nëse është e nevojshme edhe përzgjedhje në repartin adekuat ose ndërmarrrja e masave adekuate.



PODCAST



Skani kodin QR me smartphone tuaj. Do të merrni informacione të mëtejshme të dobishme për prindërit, fëmijët dhe të rinjtë.

PIKAT E KONTAKTIT

Puntorët socialë www.gl.ch/schulsozialarbeit

Ndihmë për të rinjët www.tschau.ch
www.147.ch
www.selbstsicherheit.ch

Ndihmë për prindër www.elternnotruf.ch
www.projuventute.ch
www.elternbildung.ch

Ndihmë për përdorimin
e internetit www.medienundschule.ch
www.jugendundmedien.ch

Ndihmë për temën
seksualiteti www.lustundfrust.ch
www.castagna-zh.ch
www.lilli.ch
www.bts-glarus.ch

Ndihmë për temën
i varur www.bts-glarus.ch
www.mamatrinkt.ch
www.papatrinkt.ch

Ndihmë për temën
paratë dhe borgjet www.budgetberatung.ch
www.sbg1.ch
www.schulden.ch

Ndihmë për temën
dhuna [Erwachsene Tel.143](http://www.erwachsene.tel.143)
[Kinder + Jugendliche Tel.147](http://www.kinder-und-jugendliche.tel.147)
[Opferberatungsstelle
Tel. 055 646 67 36](http://www.opferberatungsstelle.tel.055.646.67.36)







Albanisch